



MANIFESTI I LIBERAL DEMOKRATËVE EVROPIANË (ELDR) PËR ZGJEDHJET EVROPIANE TË 2009-s

Adaptuar në Kongresin e Stokholmit, 31 Tetor 2008

LIBERALËT EVROPIANË NË 15 KRYESORËT PËR ZGJEDHJET NË PARLAMENTIN EVROPIAN

Për më shumë se 60 vjet, Liberalët në Bashkimin Evropian kanë kontribuar së tepërmi për të arritur paqe, unitet dhe mirëqenie. Ne vazhdojmë të punojmë për një Bashkim më të aftë dhe më demokratik, përfundimin e një tregu të vetëm, një mjedis më të sigurt, dhe promovimin e lirive civile dhe të drejtave bazë. Ne dëshirojmë që Bashkimi të marrë rol udhëheqës në përballimin e sfidave globale për sigurinë si dhe krizës ndërkombëtare financiare dhe pasojat e saj. Bashkimi duhet të modernizohet dhe të forcohet në përputhje me vlerat dhe principet e demokracisë liberale dhe ekonomisë së tregut.

Liberalët janë grupi i tretë më i madh në Parlamentin Evropian dhe vazhdimisht kanë ushtruar influencë për sa i përket ligjeve dhe politikave.

ELDR-ja beson në nevojën për të adoptuar Traktatin e Lisbonës dhe bën thirrje që Traktati të zbatohet. Traktati reformon në mënyrë të konsiderueshme institucionet e Bashkimit Evropian, përforcon transparencën, forcon karakterin demokratik dhe e pajis BE-në me mjetet e nevojshme për sfidat e sotme globale. Liberal Demokratët Evropianë nxisin shtetet anëtare të BE-së të bien dakord mbi metodat për zbatimin e shpejtë të tij.

Liritë civile

Liritë civile dhe liria janë bazat e Evropës liberale.

1. ELDR-ja kërkon respektimin e të gjitha lirive bazë në BE, veçanërisht lirinë e shtypit, të mendimit, të fjalës, lirinë e asociimit, të besimit dhe pronësisë, respektimin e të drejtave të minoriteteve, fshehtësinë e individëve, mbrojtjen e të dhënave të tyre personale dhe dinjitetin.
2. ELDR-ja dëshiron që BE-ja të bëhet një zonë e vërtetë lirie, sigurie dhe drejtësie, dhe bën thirrje për një bashkëpunim më të fortë ndërmjet policisë dhe shërbimeve gjyqësore për të luftuar në mënyrë efikase krimin ndër-kufitar, terrorizmin dhe korrupsionin. Të drejtat procedurale bazë të të dyshuarve duhet të respektohen në të gjitha rrethanat.

Tregu i njësuar i BE-së, rritja dhe punësimi

Konkurrimi ndër-kufitar, shkëmbimi i njohurive dhe tregtia e lirë e mallrave dhe shërbimeve janë çështje thelbësore për rritjen e konkurrencës ekonomike ndërkombëtare të BE-së.

3. ELDR-ja mbështet nocionin e 'lirisë së pestë' – lëvizjen e lirshme të njohurive, duke përfshirë një lëvizje më të madhe të studentëve, akademikëve dhe studiuesve - ndërmjet shteteve anëtare, për të nxitur shpikjet dhe zbulimet. ELDR-ja bën thirrje për një treg të vetëm të pronës intelektuale.
4. ELDR-ja beson se një mjedis biznesi Evropian konkurrues është thelbësor për të arritur standardet e mundshme më të larta të jetesës për qytetarët Evropianë dhe për të promovuar standardet e BE-së në nivel global. Tregu i vetëm duhet të përforcohet dhe zgjerohet në sektorin e energjisë, shërbime postare, shërbime financiare, hekurudhave dhe kujdesit shëndetësor ndërkohë që lehtësohet më tej lëvizja e lirë e shërbimeve dhe punëtorëve, duke përfshirë këtu njohjen e mëtejshme të ndërsjellët të kualifikimeve. Brenda Organizatës Botërore të Tregtisë, BE-ja duhet të jetë forca udhëheqëse për heqjen e taksave doganore dhe barrierave pa-pagesë, dhe për hapjen e një tregu të njësuar ndaj botës së gjerë.
5. ELDR-ja riafirmon se rritja e qëndrueshme, pavarësia e Bankës Qendrore Evropiane dhe bankave qendrore kombëtare si dhe një politikë fiskale në përputhje me kriteret e Mastroitit të ndjekura nga të gjitha shtetet anëtare – që përfshijnë ata që nuk janë anëtarësuar akoma në euro – mbetet një çështje thelbësore për prosperitetin dhe mirëqenien. Vetëm një Evropë vërtetë konkurruese, që krijon vende pune dhe mundësi për të gjithë, do të vërë nën kontroll dimensionin social të tregut të njësuar.
6. ELDR-ja i mirëpret hapat e reformës për sistemin financiar dhe thekson se këto duhet të bazohen në rregulla të përmirësuara të shoqëruara me mbikëqyrjen e duhur gjatë zbatimit. Një garanci kyçe për prosperitet qëndron në përgjegjësinë personale në nivel të lartë të të gjithë pjesëmarrësve të tregut. Një kthim në politikën e nacionalizimit, në rregullat e tepruara dhe proteksionizëm do të ishin një gabim tejet i madh. ELDR-ja mbështet bashkëpunimin e intensifikuar ndërkombëtar ndërmjet rregullatorëve dhe forcimit të standardeve ndërkombëtare dhe beson se një FMN e reformuar duhet të luajë një rol udhëheqës në këtë proces në mënyrë që të parandalohen kriza të ardhshme financiare.
7. ELDR-ja mbështet krijimin e sistemit të një "karte blu" të BE-së, të administruar nga secili shtet anëtar, për të siguruar matjen e migracionit ekonomik në dobi të qytetarëve të BE-së.

Politika për mjedisin dhe energjinë

Sfida unike e ndryshimit të klimës dhe kërkesa e sigurimit të energjisë i ka unifikuar veprimet në të tërë Evropën. Evropa duhet të bëhet një ekonomi efikase me përdorim të ulët të karbonit që të udhëheqë botën në ruajtjen e energjisë së rinovueshme dhe krijimin e instrumenteve të tregut, duke siguruar nxitës për vende pune të reja.

8. EDLR-ja thekson se në paketën e BE-së, biznesi ka nevojë për uljen e pengesave administrative dhe nxitësve për të stimuluar teknikat e investimit për të përforcuar një ekonomi të fuqishme me përdorim të ulët të karbonit. ELDR-ja dëshiron të rrisë investimet në teknologji që ofrojnë zgjidhje, efikasitet dhe siguri më të madhe në furnizimin e energjisë.
9. ELDR-ja dëshiron të zbulojë industrinë e energjisë së Evropës për të siguruar transparencë dhe për t'ju shërbyer interesave të konsumatorëve, për të integruar politikat e klimës dhe energjisë bazuar në rritjen e qëndrueshme së ekonomisë, dhe për të ruajtur mjedisin natyral; e gjitha kjo për të udhëhequr globalisht.
10. ELDR-ja promovon fuqishëm një reformë ambicioze të Politikës së Përbashkët për Bujqësinë brenda kuadrit shumë-lateral (OGT). Kjo reformë do të mundësojë fermerët e BE-së që të konkurrojnë në një treg global të lirë, në mënyrë që të përmbushin më mirë kërkesat për ushqime në një mënyrë të përgjegjshme ndaj mjedisit, për t'i drejtuar fondet kundrejt energjive të rinovueshme, përfshi këtu karburantet biologjike të qëndrueshme të gjeneratës së re, dhe të garantojë furnizime të ushqimeve për një periudhë afat-gjatë. ELDR-ja mbështet uljen e buxhetit të Politikës së Përbashkët për Bujqësinë (CAP) pas vitit 2013.

Politika e zgjerimit, punët e jashtme, sigurinë dhe mbrojtjen

Në një botë të globalizuar, asnjë shtet i BE-së nuk mund të përballojë i vetëm kërcënimet dhe sfidat me të cilat po përballemi sot: menaxhimet e krizave ushtarake dhe civile, sigurimin e furnizimit me energji dhe sigurimin e tregtisë ndërkombëtare, kontrollin e armëve dhe çarmatimin, luftën kundër terrorizmit, krimin e organizuar, ndryshimin e klimës, varfërinë dhe dhunimin e të drejtave të njeriut. Qytetarët e BE-së presin nga BE-ja dhe Shtetet Anëtare që të qëndrojnë së bashku, të veprojnë së bashku dhe të luajnë një rol efektiv në punët globale.

11. ELDR-ja e konsideron procesin e zgjerimi të BE-së si një sukses dhe mbështet respektimin angazhimeve të zgjerimit aktual të BE-së për ato vende që cilat përmbushin kriteret e hyrjes në BE të përcaktuara në Kopenhagën, kriteret të cilat përfshijnë kapacitetin e integritetit si një arsye e rëndësishme.
12. ELDR-ja beson se BE-ja duhet të luajë një rol të rëndësishëm duke kontribuar me efikasitet në sigurinë globale, atje ku është e përshtatshme në bashkëpunim me strukturat e NATO-s. Për këtë arsye ne bëjmë thirrje që të bëhen përpjekje të reja madhore për të forcuar dhe zgjeruar Politikën mbi Sigurinë dhe Mbrojtjen e Evropës duke bashkuar burimet dhe mundësitë përkatëse që kanë të bëjnë me mbrojtjen. Një gjë e tillë do të përforcojë bashkëpunimin ushtarak të mbrojtjes së BE-së dhe përgjigjen e tij ndaj emergjencave ndërkombëtare të sigurisë dhe atyre humanitare.
13. ELDR-ja beson se interesave të Shteteve Anëtare të BE-së mund t'ju shërbehet më mirë nëpërmjet një Politike të Përbashkët për Punët e Jashtme dhe Sigurinë, duke folur kështu me një zë nëpërmjet Përfaqësuesit të Lartë për Politikën e Jashtme të Përbashkët dhe Sigurinë.
14. ELDR-ja thekson se BE-ja duhet të forcojë më tej mundësitë e saj për menaxhimin e krizave civile dhe të përdorë përvojën saj për të garantuar stabilitet, ligj-vënie dhe principet e qeverisjes së mirë në vendet që përballen apo kanë kaluar një situatë konflikti.

15. ELDR-ja nxit BE-në të përdorë dhe të zgjerojë më tej përvojën e saj për ngritjen e institucioneve dhe ndërtimin e kombeve pas konflikteve në mënyrë që të jetë më mirë e përgatitur për të përballuar situata të paqëndrueshmërinë rajonale, kërcënimeve terroriste që dalin nga shtetet e dështuara, si dhe emergjencat humanitare.